



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 510 Prot.

Tiranë, më datë 29.08.2025

**VENDIM**

**Nr. 460, datë 29.08.2025**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të Termave të Referencës në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 29.08.2025:

**VENDOSI**

1. Miratimin e Termave të Referencës për “Projektin e Restaurimit dhe Muzealizimit të Muzeut Kombëtar Pavarsia”, me emërtimin “Godina ku ka patur selinë Qeveria provizore e Ismail Qemalit, në Skelën e Vlorës” i shpalluar Monument Kulture i Kategorisë së I-rë me Vendim Nr. 6 datë 15.01.1963 të Rektoratit të Universitetit Shtetëror të Tiranës, me kërkesë të **Ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI)**;
2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
3. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi;
4. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETAR**  
**Joli MITROJORGJI**



**SEKRETAR**  
**Blendi GONXHJA**